



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	10-020/01-0017725/25
Nr. Javne Br. Javne Pub. Nr.	8
Data Datum Date	31.10.2025



PROCESVERBAL NGA SEANCA E 44 - të E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL TË MITROVICËS VERIORE

28.08.2025

Të pranishëm:

Antarët e kuvendit: Nedžad Ugljanin, Skender Sadiku, Flutura Hamza Azemi, Naxhije Xhema, Lumni Xhaka, Adelisa Gjushinca, Jahir Demaku, Betim Osmani, Gzim Alushi, Petrit Miftari, Arben Ismajli

Nënkryetarja e Komunës: Katarina Adjancic

Përfaqësues të OSBE – së,

Përfaqësues të KFOR- it

Mediat.

Munguan:

Dusan Milunovic

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Nedzat Ugljanin, ku si fillimi përshëndeti të pranishmit.

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kolegë, asambleistë, të nderuar mysafirë, të nderuar përfaqësues të mediave dhe përfaqësues ndërkombëtarë, të nderuar pjesëtarë të ekzekutivit.

E kemi rendin e ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e 43-të e Kuvendit Komunal
2. Vendimi për mbrojtjen e simboleve komunale
3. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore
4. Zbatimi i planit të integritetit komunal
5. Kërkesat e qytetarëve
6. Të ndryshme

Kryesuesi e hedh në votim ndryshimin e rendit të ditës dhe:

Me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenim votohet ndryshimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës pas ndryshimit:

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e 43-të e Kuvendit Komunal
2. Zbatimi i planit të integritetit komunal
3. Vendimi për mbrojtjen e simboleve komunale
4. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore
5. Kërkesat e qytetarëve
6. Të ndryshme

Pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga seanca e 43-të e Kuvendit Komunal. Kush është për?

Me 10 vota për, 1 votë kundër dhe 0 abstenim votohet procesverbali.

Betimi: Dua të arsyetoj pse votoj kundër. Ka shumë faktorë, por kryesori është se kjo është pika ku ndërpritet mbledhja dhe theksohet se kryetari i kuvendit e ka liruar dhe ka prishur kuorumin. Në fakt, nuk është ashtu sepse nëse vetëm kryetari i kuvendit e liron, nuk priset kuorumi. Nëse e keni dëgjuar, kryetari i kuvendit ka thënë se e liron kuvendin dhe e ka ftuar Adelisen ta lirojë, dhe duhej të theksohej se kryetari i ka bërë thirrje Adelises ta lirojë vendin. Duhej cekur kush e ka liruar dhe kush ka qëndruar këtu. Këto janë të rëndësishme sepse atë ditë është ndërprerë mbledhja, dhe atë ditë kemi dështuar të votojmë një pikë të rendit të ditës që tashmë nuk është më në rend dite. Kurse ju pyesni pse nuk votohet procesverbali; këto pika janë shumë të rëndësishme dhe çdo gjë që thuhet duhet të dëshmohet në dokument, sepse po të dilte vetëm kryetari, ne do të kishim kuorum.

Skenderi: Meqë edhe unë e kam votuar procesverbalin, dua që kjo vërejtje të evidentohet dhe tregojë se si është prishur kuorumi, sepse ky dokument do të mbetet. Edhe në votim duhet të dimë kush voton individualisht dhe për çfarë kundër. Kemi edhe pak mbledhje, ndoshta na nxjerrin telashe, mirëpo procesverbalet e fundit të jenë sipas gjendjes faktike të asaj që po ndodh këtu. Prapë ju kam thënë, jo si procesverbalet që kanë qenë më parë. Skenderi po flet diçka dhe tre pika, por jo, Skenderi është i vetëdijshëm se çfarë flet. Edhe këtu, nëse kryesuesi liron mbledhjen për mos të pasur kuorum, ai vetë prish kuorumin dhe kush ka mbetur është pikë pak më e rëndësishme se kush ka mbetur. Edhe sot, nëse unë liroj mbledhjen, duhet të dinë kolegët dhe opinioni se Skenderi është ai që nuk ka qenë pjesë e kuoromit. Edhe unë bashkangjitem, nuk jam penduar që votova për, edhe këtë procesverbal shpresoj të përmirësohet.

Kryesuesi: Vetëm të të shpjegoj betimin, sepse këtu shkruan shumë mirë se kryesuesi liron mbledhjen për mos të pasur kuorum. E vërtetë, e kam ftuar edhe Adelisen, por siç e dini edhe kryetari, kur ka qenë, e ka thirrur edhe nënkryetaren. Por edhe nëse do kishte kuorum dhe të liroj, mbledhja ndërpritet. Vetëm kryesuesi ka të drejtë të vendosë rendin e ditës në votim.

Skenderi: Për këtë ekziston rregullore që jam unë këtu si zëvendës kryesues. Nëse ne nuk jemi, atëherë vjen përfaqësuesi z. Jahir, kur ligji i ka parashikuar të gjitha. Por prapë them se për këtë janë pozicionuar vendet. Definitivisht një person nuk mund të prishë kuorumin kur udhëheq mbledhjen. Në mungesë të kryesuesit është zëvendësi i tij, në mungesë të dyve, ligji ka parashikuar kush ta udhëheqë, kur ka kuorum. Ku jemi tek pika e kuoromit, që nuk është prishur vetëm nga kryesuesi, por ai ka bërë ftesë edhe Adelises që të dalë dhe të lirojë sallën.

Kryesuesi: Vazhdojmë me pikën e dytë: Zbatimi i planit të integritetit komunal. Urdhëroni raportimin, znj. Antigona.

Antigona: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë ju. Meqë sot për herë të parë jam para jush, e shoh të nevojshme të prezantohem. Unë jam Antigona Sadiku dhe jam pjesë e zyrës ligjore në Komunën e Mitrovicës Veriore. Në muajin shtator të vitit 2024, me vendim të kryetarit, jam caktuar përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit komunal. Plani i integritetit komunal, të cilin ju e kam përcjellë edhe ju si dokument strategjik i hartuar nga komuna, është rezultat i vetëbesimit të institucionit karshi ekspozimit të atij institucioni kundrejt korrupsionit dhe dukurive të tjera negative. Ky plan është një dokument i rëndësishëm që ndikon në forcimin e transparencës dhe rritjen e llogaridhënies, dhe që sjell përmirësim të qeverisjes në nivel komunal. Komuna e Mitrovicës Veriore ka hartuar planin e integritetit komunal në fund të vitit 2023. Ky plan është afatgjatë për 3 vite, duke përfshirë periudhën 2024-2026. Para jush është raporti gjashtëmujor i zbatimit të këtij plani, që përfshin periudhën 1 janar deri më 31 qershor 2025. Besoj se keni pasur kohë ta shikoni dhe ta analizoni. Komuna jonë mund të themi se e ka përmbushur kënaqshëm planin e integritetit komunal, pasi prej 21 fushave që kanë qenë të parashikuara në fillim të hartimit të këtij plani, kemi ardhur në një zvogëlim të dukshëm të këtyre fushave si fusha të rrezikut. Siç e thashë më parë, komuna e ka vetëvlerësuar se ato paraqesin rrezik për integritetin e institucionit tonë. Kemi afat deri në fund të vitit 2026 ku plani duhet të përditësohet ose të ndryshohet. Edhe nëse përditësohet ose ndryshohet, duhet të kalojë përmes Kuvendit Komunal ku secili prej jush mund të japë komente apo sugjerime. Ju falënderoj për vëmendjen dhe kohën tuaj. Nëse keni ndonjë pyetje, jam në dispozicion.

Skenderi: Komplimente për punën e bërë. Edhe pse kemi të njëjtin mbiemër, është hera e parë që ju shoh që nuk mendojnë se kemi familjarizëm. Integriteti ka të bëjë me çështje korrupsioni, siç shikova.

Por mendoj se është mirë të ruajmë integritetin individual dhe të komunës, të përgëzoj për punën dhe shpresoj që si Asamble t'i inkadrojmë edhe kolegët që nëse votohet, ta votojnë.

Antigona: Faleminderit, kjo nuk është pikë që kërkon të votohet, si obligim ligjor është raportim për parandalimin e korrupsionit, për hir të transparencës ishte ky raportim sot, faleminderit shumë.

Kryesuesi: Në emër të Kuvendit ju falënderoj për punën që keni bërë, sepse zbatimi i planit të integritetit komunal është shumë i rëndësishëm, sidomos hera e parë që ka ardhur në kuadër të Kuvendit, ku siç e cek edhe Skenderi, po ashtu edhe Znj. Antigona, ku është më shumë për korrupsion, ku secili e kemi obligim që ta luftojmë anët negative, dhe nëpërmjet kësaj besoj se do të ketë përkrahje nga Kuvendi Komunal. Faleminderit për raportimin, nëse nuk keni ndonjë pyetje, Znj. Antigona është e lirë.

Kryesuesi: Kalojmë te pika e tretë, Vendimi për mbrojtjen e simboleve komunale. Ju shpjegoj se në thirrjen për mbledhjen ka qenë vendimi për mbrojtjen e simboleve institucionale të Republikës së Kosovës. Unë e kam parashikuar se edhe simbolet komunale janë simbole institucionale, ku simbolet e Republikës së Kosovës janë të mbrojtura me ligjshmëri, por simbolet komunale sipas paralajmërimeve nga disa subjekte politike që kanë disa synime, dhe synimi i parë do të jetë që vendimi i simboleve komunale – sepse ne kemi votuar në kuadër të Kuvendit dhe është miratuar dhe sipas protokollit i kemi përfunduar – dhe më pas ekzekutivi, sipas 3 apo 5 ofertave që ka pasur, i ka votuar përmes Kuvendit simbolin komunal. Unë kam biseduar me ministrin dhe është një zbrazëti, ku kuvendet komunale në fakt nuk i kanë të mbrojtura simbolet komunale, por ne si Kuvend kemi kërkuar nga ministria që çdo vepër e cenuar të jetë ndaj simboleve, pa marrë parasysh të jetë edhe simboli komunal, i përfshirë si vepër penale. Në fakt ne do përfundojmë një lloj vendimi që do ta përcjellim në ministri, ku nuk e dimë nëse do të jetë negativ apo pozitiv nga ministria. Unë ju thashë cili është shkaku, ku i pari vendim ata që do jenë pjesë e Kuvendit mendoj që do ta cenonjë këtë vendim, sidomos simbolin komunal. Sipas vendimit tonë dhe sipas procedurave që kemi përfunduar, kemi përfunduar edhe obligimet tona ligjore, dhe ligjërisht duhet të mbrohen pa marrë parasysh se kush do të jetë në kuadër të Kuvendit, sepse jemi të gjithë të zëvendësueshëm. Çfarëdo që është miratuar në kuadër të Kuvendit duhet të mbrohet ligjërisht. Do t'i mbrojmë çdo vendim sepse secili ka qenë në përputhje me qeverisjen lokale.

Betimi: Lidhur me këtë çështje për mbrojtjen e simboleve komunale, më mirë do të ishte të bëhej një rregullore për formën apo rregullimin e përdorimit të simboleve shtetërore apo kombëtare për regionin e Mitrovicës, sepse kaq kemi kompetencë, ndërsa kjo për mbrojtjen e simboleve komunale është kompetencë e secilës Asamble që vjen, ku secila ka të drejtën dhe ne nuk mundemi t'i ndalojmë të bëjnë të njëjtën gjë që kemi bërë ne. Më mirë do të ishte të ndryshohej dhe ta lejmë për herën tjetër, ku do të shohim një rregullore për përdorimin e simboleve të shtetit dhe të gjitha komuniteteve, që të mund ta përdorë secili komunitet simbolin e vet, por në ditë të caktuara, do të ishte më normale sesa kjo që marrim vendim dhe kjo nuk përfundon punë asgjë, nuk ia mohon të drejtën askujt ku Asambleja e ardhshme ka të drejtën e vet.

Kryesuesi: Unë vetëm ju tregova se çfarë është cenimi, sepse prologimet nga subjektet shumicë nga komuniteti serb kanë qenë edhe përmes mediave. Unë e di se mbrojtja institucionale e flamurit të Republikës së Kosovës nuk guxon të preket, por ata në një formë kanë lënë

përgjegjësinë në anën tonë, sepse diçka që do të cenohet një simbol që ka funksionuar në strukturat paralele komunale në pjesën veriore ta sjellin në këtë institucion. Ne mundemi të bëjmë rregullore, mirëpo është ligji i përcaktuar për mbrojtjen e simboleve, poashtu është edhe ligji për mbrojtjen e simboleve të komuniteteve. Ne s'mundemi të sjellim rregullore në kuadër të Kuvendit, ne mundemi vetëm me rregullore për simbolin komunal, sepse janë parashikuar datat e komuniteteve, të simboleve, por edhe mbrojtja institucionale e flamurit të Kosovës në çdo institucion.

Skenderi: Po frikësohem sepse edhe gjërat më normale i kemi duke i komplikuar. Më duhet të potencoj se Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është shkruar as nga serbët as nga shqiptarët, por atë e ka shkruar Martti Ahtisaari, dhe aty mbrohen me ligj të gjitha simbolet. Ne e kemi përfunduar në mënyrë të rregullt, mos u brengosni. Në pyetje është një logo dhe një flamur që është i vendosur në oborrin e Komunës, ne nuk kemi ndonjë simbol më të madh. Çfarë është varur nga ne kemi përfunduar mirë. Pjesa ka qenë edhe në publik nga shumë punë që është dashur të përfundojnë në shpejtësi është përfunduar si duhet. Ka qenë komisioni, ka qenë piktor serb, kanë qenë akademikë që kanë marrë pjesë aty, edhe simboli i brendshëm, kjo përmendore është e punuar nga një serb, Bogdan Bogdanoviq, është autor i monumentit që është në këtë simbol, ka qenë antifashist, ka qenë kryetar i Bashkisë së Beogradit. Në simbolin tonë ngjyrat i kemi të minatorëve dhe lumenjve, vizualisht mund të jetë më mirë ose më keq, por përmbajtja nuk e simbolizon këtë qytet. Ne shohim edhe në rrugë, zebrat kanë ngjyra pikërisht të saj. Pretendimet nuk i di dhe as nuk dua të bëj reklamë, kushdo që vjen. Janë ligjet, rregulloret dhe statuti i komunës, i cili e obligon komunën të ketë simbol. Mirëpo për këtë moment ne e kemi votuar dhe kemi qenë duke respektuar të gjitha kriteret dhe specifikat që kemi në qytetin tonë. Nuk ka ngjyra të ndonjë komuniteti, as simbole të ndryshme, dhe mendoj se për një gjë që kemi votuar ta mbrojmë.

Kryesuesi: A do bëjmë një vendim dhe ta dërgojmë, sepse them se është një zbrazëti, të bëjmë një vendim. Poashtu pajtohem me Betimin që duhet një rregullore, nëse bëhet një rregullore e bëjmë në nivel komunal.

Kryesuesi e hedh në votim.

Vendimi për mbrojtjen e simboleve komunale u votua me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi: Vazhdojmë me pikën e katërt, Propozim-Vendim për ndryshimin e destinimit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.

Kryesuesi: E lexon propozim-vendimin dhe e hedh në votim. Dikush për të shtuar diçka?

Skenderi: Dua ta shfrytëzoj momentin, meqë është në dy gjuhë, është një pikë e ndjeshme sa më përket mua. Në vend të urimit dua të kërkoj falje për shkollën Konteiner, ndihem i turpëruar si asambleist, Mitrovicali dhe individ. E di se do na falin sepse janë fëmijë, por si do ia falim vetes kur edhe një vit shkollor do trajtohen jo dinjitetshëm fëmijët dhe t'i dërgojnë të marrin dituri në shkollën Konteiner? Këtë turp duhet ta mbajmë, ministria dhe të gjithë ata që kemi pasur mundësi të japim më shumë. Kjo është thirrja ime e fundit që dinjitetshëm t'i trajtojmë fëmijët. Në vend që t'i urojmë 1 Shtatorin në shkollë të dinjitetshme, ne po i zgjatim vuajtjet e tyre. Sot do të votohet për një pjesë, por është votim i vonshëm për ata fëmijë, për një gjeneratë që po e

rrisim jo dinjitetshëm. Bëj apel që në çfarëdo mënyre të gjendet mënyra të mendojmë për të ardhmen e tyre dhe jo t'i dërgojmë në shkollë-konteiner në shekullin 21. Faleminderit.

Kryesuesi: Faleminderit. Do doja të kyçem në këtë temë, sepse ata fëmijë kanë qenë peng për 25 vjet, edhe fëmijët në lagjen e Boshnjakëve, edhe në pjesë tjera. Mirëpo, ne po votojmë për një shkollë që do të jetë në përgjegjësi të pjesës veriore. Siç e dini, kemi votuar një ndihmë, por nuk kemi mundur ta realizojmë për shkak të pengesave, sepse është në drejtori të pjesës jugore të qytetit. Pa marrë parasysh nëse ka qenë zyra administrative apo komuna e pjesës veriore apo jugore, kam qenë disa herë së bashku me disa anëtarë dhe kryesuesen e Komisionit për Komunitete, ku kemi tentuar të bëjmë diçka. Mirëpo pengesa më e madhe ka qenë që është nën administrim të pjesës së jugut. Por tashmë do të kemi shkollën dhe ata do të lirohen dhe do të kenë shkollën e tyre, sepse fëmijët e pjesës veriore janë dashur të shkojnë në shkollë në pjesën jugore, ku kanë hasur në qen endacak që janë sulmuar. Gjithmonë kanë pasur brengosje edhe familjarët. Kurse tash jemi në situatë që kemi votuar për çerdhën dhe tash edhe për shkollën, ku kjo shkollë do t'u takojë banorëve të pjesës veriore. E dimë që kemi përballë sfidën që kjo shkollë të votohet për banorët e pjesës veriore. A mundemi ta hedhin në votim?

Propozim-vendimi për ndryshimin e destinimit të tokës, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, u votua me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi: Uroj që ajo shkollë të hapë dyert sa më parë që fëmijët të shkojnë përpara.

Kryesuesi: Kalojmë tek pika tjetër, kërkesat e qytetarëve, ku kemi disa kërkesa që kemi shqyrtuar në KPF. Para se të vijojmë në mbledhje, kam biseduar me drejtorin e financave dhe kam pyetur sa kemi mundësi që përsëri t'i ndihmojmë rasteve në nevojë me sëmundje të rënda tash në përfundim të mandatit. Jam i obliguar t'i lexoj të gjitha kërkesat që janë adresuar në Kuvendin Komunal. Kryesuesi fillon leximin e kërkesave të qytetarëve.

Aida: Faleminderit kryesues. Për këto tre raste, me gjasë kemi biseduar edhe në KPF dhe jemi pajtuar si komision që secilit t'i ndahen nga 500€, të ndahen si Kuvend. Shpresoj shumë që edhe anëtarët e Kuvendit të votojnë për këtë shumë, që është modeste dhe e arsyeshme nga ana jonë. Nuk e di saktë sa ka buxhet Kuvendi, por nëse kemi mundësi ta rrisim shumën, akoma edhe më mirë, nëse ka hapësirë.

Kryesuesi: Për këtë arsye kam kontaktuar drejtorin e financave dhe kemi në dispozicion edhe 3500€, por kemi këto mjete për të votuar.

Skënderi: Të nderuar kolegë, i keni hapur një rrugë që tashmë na është kthyer, nuk mundemi edhe me 500€ të rikthejmë dinjitetin. Brenda kësaj komune ekziston Drejtoria e Shëndetësisë, ne në Kuvend nuk jemi mjekë, derisa ekziston Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Shëndetësisë dhe derisa pacientë me kancer vijnë në adresën tonë, nuk është korrekte. Drejtoria e Shëndetësisë ka dhënë diku mbi 200.000€ nga buxheti komunal, por pikërisht kjo drejtori nuk mund t'i ndihmojë këtyre rasteve. Jam në proces me Elektroservisin ku duhet të trajtohet edhe çështja e rrymës. Po flas që, derisa ekzistojnë institucionet, ekzistojnë drejtori për këto raste dhe do krijojmë një task-forcë. Jemi për të ndihmuar, por ekziston ligji dhe fondi për mbrojtje shëndetësore dhe sociale. A jemi duke i drejtuar këta njerëz në ato fonde? Jemi duke marrë rolin

e mjekut për vota, nuk jeni duke bërë për njerëzit, por për vete, për vota. Nëse doni të votoni pa i parë kërkesat e qytetarëve, mbetet në ndërgjegjen tuaj. Edhe një apo dy mbledhje i kemi për të mbajtur dinjitetin dhe mos luani me raste sociale, sepse edhe këta kërkojnë dinjitet. Këtyre qytetarëve duhet t'u paguhet rryma, t'u jepet ndihma sociale.

Aida: E dimë që Komuna e Mitrovicës Veriore ka subvencionuar shumë pacientë apo kërkesa të shumta, ku janë ndarë mjete 300 apo 500 euro për sëmundje me kancer. Por këto tre raste janë drejtuar tek ne si Kuvend, ndoshta janë drejtuar edhe tek Drejtoria e Shëndetësisë. Por gjithsesi, kur na vijnë këso raste, është njerëzore t'u ndihmojmë. Nuk është hera e parë që e bëjmë. Tashmë jemi para fushatës zgjedhore dhe ne gjithmonë ju kemi ndihmuar. Z. Skënder, këtyre rasteve nuk është hera e parë. Megjithatë, të gjitha etnitë dhe kjo më lumturon shumë. Jemi duke u munduar dinjitetshëm. E di që me atë shumë nuk i mjaftojnë, sepse kam rast me kancer në shtëpi, mirëpo kjo është mundësia si Kuvend i Komunës që t'u ndihmojmë. Nuk kuptoj as çka deshe të thuash.

Skënderi: Duhet të ruajmë dinjitetin, jo në mbledhjet e fundit t'u ndihmojmë. Këto raste duhet të dërgohen tek Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

Kryesuesi: Ne kemi këtë mundësi njerëzore si Kuvend ku kemi mjetet e subvencioneve dhe ato i ndajmë. Tashmë prit nga drejtoritë, këto raste nuk guxojnë të presin. Janë raste të rënda që i cek edhe znj. Aida. Ne që nga fillimi kemi ndihmuar. Edhe zyra e kryetarit ka ndihmuar, por neve si Kuvend na janë drejtuar këto raste. Unë e hedh në votim, kush jeni për?

Kërkesat e qytetarëve për ndihmë nga 500€ u votuan me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi: Kemi edhe dy kërkesa që na janë drejtuar nga Organizata për Mbrojtjen e Kafshëve SHAPA. Kryesuesi fillon të lexojë kërkesën e OJQ SHAPA.

Skënderi: Vetëm një gjë: në lagjen e Doktorëve është sulmuar një fëmijë, ndërkohë ka filluar prapë helmimi i qenve endacak. Tash do të them, për shkak të mediave. I drejtohem mediave në gjuhën serbe, arsyetoj nevojën për ndihmë për OJQ SHAPA lidhur me çështjen e qenve të pastrehë.

Kryesuesi: A mundemi ta hedhim në votim? Sepse unë mendoj se subvencionet e Kuvendit i kemi të drejtë t'i orientojmë sipas kërkesave të qytetarëve. A janë të qytetarëve apo të OJQ-ve? Ne kemi të drejtë t'i ndihmojmë qytetarët nga subvencionet e Kuvendit.

Kryesuesi: E hedhim në votim kërkesën që na është drejtuar nga Organizata për Mbrojtjen e Kafshëve SHAPA. Kush jeni për?

Kërkesa që është bërë nga Organizata për Mbrojtjen e Kafshëve SHAPA për ndihmë me 1500€ u votua me 11 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi: Lexon kërkesën e qytetarëve të lagjes së Tre Rrokaqiejve, të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike për qëllime të parkingut.

Kryesuesi: Gjithashtu lexon edhe një kërkesë tjetër në lidhje me emërtimin e Ures së Re, por e njëjta vlerësohet të mos jetë në kompetencë të Kuvendit Komunal.

Mbyllja e mbledhjes:

Kryesuesi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe mbylli mbledhjen

Mbledhja përfundoi në orën 16:25.

Procesmbajtës:

Bujar ISUFI



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Nedzat UGLJANIN





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	10-03061-0017725/5
Nr. i fazeve Bë. stranska	8	Data Datum Date	31.10.2025



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

ZAPISNIK SA 44. REDOVNE SEDNICE SKUPŠTINE OPŠTINE SEVERNA MITROVICA

28.08.2025

Prisutni:

Odbornici Skupštine: Nedžad Ugljanin, Skender Sadiku, Flutura Hamza Azemi, Naxhije Xhema, Lumni Xhaka, Adelisa Gjushinca, Jahir Demaku, Betim Osmani, Gzim Alushi, Petrit Miftari, Arben Ismajli.

Zamenica Gradonačelnika: Katarina Adančić

Predstavници OEBS-a,

Predstavници KFOR-a

Mediji

Odsutan:

Dušan Milunović

Sednicu je otvorio Predsedavajući Skupštine, g.Nedžad Ugljanin, koji je na početku pozdravio prisutne.

Pozdrav svim prisutnima, uvaženim kolegama, članovima skupštine, uvaženim gostima, uvaženim predstavnicima medija i međunarodnim predstavnicima, uvaženim članovima izvršne vlasti.

Imamo dnevni red:

1. Usvajanje zapisnika sa 43. sednice Skupštine opštine
2. Odluka o zaštiti opštinskih simbola
3. Predlog odluke o promeni namene zemljišta sa poljoprivrednog na građevinsko zemljište
4. Sprovođenje plana integriteta opštine
5. Zahtevi građana
6. Razno

Predsedavajući predlaže izmenu tačaka Dnevnog reda: četvrta tačka da se pređe na drugu tačku, a redosled ostalih tačaka da se nastavi kako jeste.

Predsedavajući stavlja izmenu dnevnog reda na glasanje i:

Sa 11 glasova za, 0 protiv, 0 uzdržanih, izmena dnevnog reda je izglasana.

Dnevni red nakon izmene:

1. Usvajanje zapisnika sa 43. sednice Skupštine opštine
2. Sprovođenje plana integriteta opštine
3. Odluka o zaštiti opštinskih simbola
4. Predlog-odluke o promeni namene zemljišta sa poljoprivrednog na građevinsko zemljište
5. Zahtevi građana
6. Razno

Prva tačka: Usvajanje zapisnika sa 43. sednice Skupštine opštine. Ko je za?

Sa 10 glasova za, 1 glasom protiv i 0 uzdržanih, glasa se o zapisniku.

Betim: Želim da opravdam zašto glasam protiv. Postoji mnogo faktora, ali glavni je da je ovo tačka gde se sednica prekida i navodi se da je predsednik skupštine raspustio i prekršio kvorum. U stvari, to nije slučaj jer ako samo predsednik skupštine raspusti, kvorum nije prekršen. Ako ste čuli, predsednik skupštine je rekao da je raspustio skupštinu i pozvao Adelizu da je napusti, a trebalo je naglasiti da je predsednik pozvao Adelizu da napusti mesto. Trebalo je navesti ko ju je raspustio, a ko je ostao ovde. Ovo je važno jer je tog dana sednica prekinuta, i tog dana nismo uspeli da glasamo o tački dnevnog reda koja više nije na dnevnom redu. I pitate zašto se ne glasa o zapisniku; ove tačke su veoma važne i sve što se kaže mora biti dokazano u dokumentu, jer da se pojavio samo predsednik skupštine, imali bismo kvorum.

Skender: Pošto sam i ja glasao o zapisniku, želim da se ova opaska zabeleži i da se pokaže kako je kvorum prekršen, jer će ovaj dokument ostati. Čak i na glasanju, moramo znati ko pojedinačno glasa, a za šta protiv. Još uvek imamo nekoliko sastanaka, možda nam oni prave probleme, ali najnoviji zapisnik treba da bude prema činjeničnom stanju onoga što se ovde dešava. Ponovo sam vam rekao, ne kao zapisnici koji su bili pre. Skender nešto govori i tri tačke, ali ne, Skender je svestan šta govori. Čak i ovde, ako predsedavajući raspusti sastanak zbog nedostatka kvoruma, on sam raspušta kvorum i ko je ostao je malo važnija tačka od toga ko je ostao. Čak i danas, ako raspustim sastanak, moje kolege i javnost treba da znaju da je Skender taj koji nije bio deo kvoruma. Takođe se slažem, ne žalim što sam glasao za, nadam se da će i ovaj zapisnik biti poboljšan.

Predsedavajući: Dozvolite mi samo ti objasnim Betim, jer ovde veoma jasno piše da Predsedavajući raspušta sednicu zbog nedostatka kvoruma. Istina, pozvao sam i Adelisu, ali kao što znate, gradonačelnik, kada je bio tamo, pozvao je i Zamenicu Gradonačelnika. Ali čak i ako je bilo kvoruma i ja raspustim, sednica se odlaže. Samo Predsedavajući ima pravo da stavi dnevni red na glasanje.

Skender: Za ovo postoji propis da sam ja ovde kao Zamenik predsedavajućeg. Ako nismo, onda dolazi predstavnik g. Jahir, kada je zakon sve predvideo. Ali i dalje kažem da su za to mesta postavljena. Definitivno jedna osoba ne može da naruši kvorum kada vodi sastanak. U odsustvu predsedavajućeg tu je njegov zamenik, u odsustvu obojice, zakon je predvideo ko će ga voditi, kada postoji kvorum. Kad smo u tački kvoruma, koji nije narušio samo Predsedavajući, već je pozvao i Adelisu da izađe i napusti salu.

Predsedavajući: Nastavljamo sa drugom tačkom: Sprovođenje plana integriteta opštine. Izvolite sa izveštajem, g. Antigona.

Antigona: Hvala vam, Predsedavajući, pozdrav svima vama. Pošto sam danas prvi put pred vama, smatram da je potrebno da se predstavim. Ja sam Antigona Sadiku i deo sam pravne kancelarije u opštini Severna Mitrovica. U septembru 2024 godine, odlukom gradonačelnika, imenovana sam za odgovornu za praćenje sprovođenja plana integriteta opštine. Plan integriteta opštine, koji sam vam prosledila kao strateški dokument koji je sastavila opština, rezultat je samopouzdanja institucije suočene sa izloženošću te institucije korupciji i drugim negativnim pojavama. Ovaj plan je važan dokument koji utiče na jačanje transparentnosti i povećanje odgovornosti, i koji donosi poboljšanje upravljanja na opštinskom nivou. Opština Severna Mitrovica je krajem 2023. godine izradila plan integriteta opštine. Ovaj plan je dugoročan na 3 godine, uključujući period 2024-2026. Pred vama je šestomesečni izveštaj o sprovođenju ovog plana, koji obuhvata period od 1. januara do 31. juna 2025 godine. Verujem da ste imali vremena da ga pogledate i analizirate. Naša opština može reći da je zadovoljavajuće ispunila plan integriteta opštine, budući da smo od 21 oblasti koje su bile predviđene na početku izrade ovog plana, došli do značajnog smanjenja ovih oblasti kao oblasti rizika. Kao što sam već rekao, opština je samoprocenila da predstavljaju rizik po integritet naše institucije. Imamo rok do kraja 2026. godine da ažuriramo ili izmenimo plan. Čak i ako se ažurira ili menja, mora proći kroz Skupštinu opštine gde svako od vas može dati komentare ili sugestije. Hvala vam na pažnji i vremenu. Ako imate bilo kakvih pitanja, stojim vam na raspolaganju.

Skender: Komplimenti za obavljeni posao. Iako imamo isto prezime, prvi put vas vidim da ne mislite da se radi o nepotizmu. Integritet se tiče pitanja korupcije kao što sam video.

Ali mislim da je dobro očuvati individualni i opštinski integritet, čestitam vam na vašem radu i nadam se da ćemo kao Skupština uključiti i naše kolege kako bi, ako se o tome glasa, i oni glasali za to.

Antigona: Hvala vam, ovo nije tačka koja zahteva glasanje, kao zakonska obaveza to je izveštaj o sprečavanju korupcije, radi transparentnosti ovaj izveštaj je danas sačinjen, hvala vam puno.

Predsedavajući: U ime Skupštine, zahvaljujem vam se na radu koji ste obavili, jer je sprovođenje plana integriteta opštine veoma važno, posebno prvi put kada je došlo u okvir Skupštine, gde je, kao što je pomenuo Skenderi, kao i gospođa Antigona, više reč o korupciji, gde svako od nas ima obavezu da se bori protiv negativnih strana, i kroz ovo verujem da će biti podrške od Skupštine opštine. Hvala vam na izveštaju, ako nemate pitanja, g. Antigona je slobodna.

Predsedavajući: Pređimo na treću tačku, Odluku o zaštiti opštinskih simbola. Objašnjavam vam da je u pozivu za sastanak bila odluka o zaštiti institucionalnih simbola Republike Kosovo. Predviđao sam da su opštinski simboli takođe institucionalni simboli, gde su simboli Republike Kosovo zakonski zaštićeni, ali opštinski simboli prema najavama nekih političkih subjekata koji imaju nekoliko ciljeva, a prvi cilj će biti da se odluka o opštinskim simbolima – jer smo glasali unutar Skupštine i ona je usvojena i prema protokolu smo je završili – a zatim izvršna vlast, prema 3 ili 5 ponuda koje je imala, glasa o opštinskom simbolu kroz Skupštinu. Razgovarao sam sa ministrom i postoji praznina, gde opštinske skupštine zapravo nemaju zaštićene opštinske simbole, ali mi kao Skupština smo zahtevali od ministarstva da se svaki čin kršenja simbola, bez obzira da li je to i opštinski simbol, uključi kao krivično delo. U stvari, mi ćemo finalizovati neku vrstu odluke koju ćemo proslediti ministarstvu, gde ne znamo da li će biti negativna ili pozitivna od strane ministarstva. Rekao sam vam koji je razlog, gde je prva odluka da oni koji će biti deo Skupštine mislim da će prekršiti ovu odluku, posebno simbol opštine. Prema našoj odluci i prema procedurama koje smo završili, mi smo takođe ispunili svoje zakonske obaveze, i pravno one moraju biti zaštićene bez obzira na to ko će biti u Skupštini, jer smo svi zamenljivi. Sve što je usvojeno u Skupštini mora biti pravno zaštićeno. Branićemo svaku odluku jer je svaka bila u skladu sa lokalnom samoupravom.

Betim: Što se tiče ovog pitanja zaštite opštinskih simbola, bilo bi bolje da se donese propis o obliku ili regulisanju upotrebe državnih ili nacionalnih simbola za region Mitrovice, jer je to naša nadležnost, dok je ovo za zaštitu opštinskih simbola nadležnost svake predstojeće Skupštine, gde svako ima pravo i ne možemo ih sprečiti da rade isto što smo mi uradili. Bolje bi bilo da se to promeni i ostavi za sledeći put, gde ćemo videti propis o upotrebi državnih simbola i svih zajednica, da svaka zajednica može da koristi svoj simbol, ali određenim danima, bilo bi normalnije od ovoga da mi donesemo odluku i da se time ništa ne završava, ne uskraćuje se nikome pravo tamo gde sledeća Skupština ima svoje pravo.

Predsedavajući: Upravo sam vam rekao šta je prekršaj, jer su prolozi od većinskih subjekata iz srpske zajednice takođe prošli kroz medije. Znam da institucionalna zaštita zastave Republike Kosovo ne sme biti pogođena, ali su na neki način ostavili odgovornost na našoj strani, jer nešto što će prekršiti simbol koji je funkcionisao u paralelnim opštinskim strukturama u severnom delu, dovešće ga u ovu instituciju. Možemo donositi propise, ali postoji zakon koji je uspostavljen za zaštitu simbola, kao i zakon za zaštitu simbola zajednice. Ne možemo donositi propise unutar Skupštine, možemo samo propisima za opštinski simbol, jer su predviđeni datumi zajednica, simbola, ali i institucionalna zaštita zastave Kosova u svakoj instituciji.

Skender: Plašim se jer komplikujemo čak i najnormalnije stvari. Moram da naglasim da Ustav Republike Kosovo nisu pisali ni Srbi ni Albanci, već ga je pisao Marti Ahtisari, i tamo su svi simboli zaštićeni zakonom. Završili smo ga uredno, ne brinite. Pitanje je logo i zastava koja se postavlja u dvorištu Opštine, nemamo nijedan veći simbol. Dobro smo završili ono što je zavisilo

od nas. Deo koji je takođe bio u javnosti, od mnogih poslova koji su morali brzo da se završe, završen je kako treba. Bila je komisija, bio je srpski slikar, bili su akademici koji su tamo učestvovali, čak je i unutrašnji simbol, ovaj spomenik je napravio Srbin, Bogdan Bogdanović, on je autor spomenika koji se nalazi u ovom simbolu, bio je antifašista, bio je gradonačelnik Beograda. U našem simbolu imamo boje rudara i reka, vizuelno je možda bolje ili gore, ali sadržaj ne simbolizuje ovaj grad. Vidimo i na ulici, zebre imaju upravo njegove boje. Ne znam tvrdnje i ne želim da se reklamiram, ko god da dođe. Postoje zakoni, propisi i statut opštine, koji obavezuju opštinu da ima simbol. Ali za sada smo glasali i poštujemo sve kriterijume i specifičnosti koje imamo u našem gradu. Nema boja bilo koje zajednice, niti različitih simbola, i mislim da smo glasali za nešto što treba zaštititi.

Predsedavajući: Da li da donesemo odluku i da je pošaljemo, jer kažem da je to praznina, hajde da donesemo odluku. Slažem se i sa Betimom da je potreban propis, ako se donosi propis, radimo to na opštinskom nivou.

Predsedavajući stavlja pitanje na glasanje.

Odluka o zaštiti opštinskih simbola je izglasana sa 11 glasova za, 0 protiv, 0 uzdržanih.

Predsedavajući: Nastavljamo sa četvrtom tačkom, Predlogom-odlukom o promeni namene zemljišta, sa poljoprivrednog na građevinsko zemljište.

Predsedavajući: Čita Predlog- odluku i stavlja ga na glasanje. Da li neko ima šta da doda?

Skender: Želim da iskoristim trenutak, pošto je na dva jezika, to je osetljiva tačka što se mene tiče. Umesto čestitanja, želim da se izvinim zbog škole kontejner, osećam sramotu kao poslanik, stanovnik Mitrovice i pojedinac. Znam da će nam oprostiti jer su deca, ali kako ćemo sebi oprostiti kada će se još jedna školska godina deca tretirati bez dostojanstva i slati da stiču znanje u Kontejnersku školu? Moramo da podnesemo ovu sramotu, ministarstvo i svi oni koji su imali priliku da daju više. Ovo je moj poslednji poziv da se prema deci odnosimo dostojanstveno. Umesto da im čestitamo 1. septembar u dostojanstvenoj školi, mi produžavamo njihovu patnju. Danas će se glasati za čast, ali je to kasno glasanje za tu decu, za generaciju koju odgajamo bez dostojanstva. Apelujem da na bilo koji način pronađemo način da razmišljamo o njihovoj budućnosti i da ih ne šaljemo u kontejnersku školu u 21 veku. Hvala vam.

Predsedavajući: Hvala vam. Želeo bih da se pridružim ovoj temi, jer su ta deca taoci već 25 godina, kako deca u Bošnjačkoj mahali, tako i u drugim delovima. Međutim, glasamo za školu koja će biti pod nadležnošću severnog dela. Kao što znate, glasali smo za pomoć, ali je nismo mogli sprovesti zbog prepreka, jer je u direkciji južnog dela grada. Bez obzira da li je u pitanju bila administrativna kancelarija ili opština severnog ili južnog dela, nekoliko puta sam bio zajedno sa nekim članovima i predsednicom Komisije za zajednice, gde smo pokušali nešto da uradimo. Ali najveća prepreka je bila to što je pod upravom južnog dela. Ali sada ćemo imati školu i oni će biti pušteni i imaće svoju školu, jer su deca iz severnog dela morala da idu u školu u južnom delu, gde su nailazila na pse lutalice koji su ih napadali. Uvek je bilo zabrinutosti porodica. A sada smo u situaciji gde smo glasali za vrtić, a sada za školu, gde će ova škola pripadati stanovnicima severnog dela. Znamo da se suočavamo sa izazovom da ova škola bude izglasana za stanovnike severnog dela. Možemo li to staviti na glasanje?

Predlog odluke o promeni namene zemljišta sa poljoprivrednog na građevinsko zemljište izglasan je sa 11 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Predsedavajući: Nadam se da će škola što pre otvoriti svoja vrata kako bi deca mogla da krenu napred.

Predsedavajući: Pređimo na sledeću tačku, zahteve građana, gde imamo nekoliko zahteva koje smo pregledali u OPF-u. Pre nego što sam nastavio sastanak, razgovarao sam sa Direktorom finansija i pitao koliko imamo mogućnosti da ponovo pomognemo slučajevima kojima je potrebna pomoć sa teškim bolestima sada na kraju mandata. Dužan sam da pročitam sve zahteve koji su upućeni Skupštini opštine. Predsedavajući počinje sa čitanjem zahteva građana.

Aida: Hvala vam Predsedavajući. Za ova tri slučaja, verovatno smo i mi razgovarali u OPF-u i složili se kao odbor da se svakom od njih dodeli po 500 evra, da se dodeli kao Skupština. Zaista se nadam da će i članovi Skupštine glasati za ovaj iznos, koji je skroman i razuman sa naše strane. Ne znam tačno koliko Skupština ima u svom budžetu, ali ako imamo mogućnost da povećamo iznos, još bolje, ako ima prostora.

Predsedavajući: Iz tog razloga, kontaktirao sam finansijskog direktora i imamo još 3.500 evra na raspolaganju, ali imamo ta sredstva za glasanje.

Skënder: Poštovane kolege, otvorili ste put koji nam je već vraćen, ne možemo ni sa 500 evra da vratimo dostojanstvo. U okviru ove opštine postoji Direkcija za zdravstvo, mi u Skupštini nismo lekari, dok postoji Direkcija za socijalnu zaštitu, Direkcija za zdravstvo i dok nam na adresu dolaze oboleli od raka, to nije ispravno. Direkcija za zdravstvo je dala negde preko 200.000 evra iz opštinskog budžeta, ali baš ta direkcija ne može da pomogne ovim slučajevima. U procesu sam sa Elektroslužbom gde se takođe mora rešiti pitanje struje. Govorim o tome da, dok postoje institucije, postoje direkcije za ove slučajeve i napravićemo radnu grupu. Mi smo tu da pomognemo, ali postoji zakon i fond za zdravstvo i socijalnu zaštitu. Da li mi usmeravamo ove ljude ka tim fondovima? Preuzimamo ulogu lekara za glasove, vi to ne radite za narod, već za sebe, za glasove. Ako želite da glasate, a da ne gledate zahteve građana, to ostaje na vašoj savesti. Imamo još jedan ili dva sastanka da bismo održali dostojanstvo i ne igrali se društvenim prilikama, jer i ovi ljudi zahtevaju dostojanstvo. Ovim građanima treba platiti struju, dati im socijalnu pomoć.

Aida: Znamo da je Opština Severna Mitrovica subvencionisala mnoge pacijente ili brojne zahteve, gde je izdvojeno 300 ili 500 evra za rak. Ali ova tri slučaja su nam upućena kao Skupštini, možda su upućeni i Direkciji za zdravstvo. Ali u svakom slučaju, kada nam takvi slučajevi dođu, humano je da im pomognemo. Ovo nije prvi put da to radimo. Već smo pred izbornom kampanjom i uvek smo vam pomagali. Gospodine Skender, ovo nije prvi put za ove slučajeve. Međutim, sve etničke grupe i ovo me čini veoma srećnim. Trudimo se dostojanstveno. Znam da sa tim iznosom nisu dovoljni, jer imam slučaj raka kod kuće, ali ovo je prilika kao Skupštine opštine da im pomognemo. Čak ni ne razumem šta ste hteli da kažete.

Skënderi: Moramo da sačuvamo dostojanstvo, a ne da im pomažemo na poslednjim sastancima. Ove slučajeve treba poslati Direkciji za zdravstvo i Direkciji za socijalnu zaštitu.

Predsedavajući: Imamo ovu ljudsku priliku kao Skupština gde imamo sredstva za subvencije i raspodeljujemo ih. Već čekamo od direkcija, ovi slučajevi ne mogu da čekaju. To su ozbiljni slučajevi koje je gospođa Aida takođe pomenula. Pomagali smo od početka. Kancelarija gradonačelnika je takođe pomagala, ali ovi slučajevi su nam upućeni kao Skupštini. Stavljam na glasanje, za koga ste?

Zahtevi građana za pomoć od 500 evra glasani su sa 11 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Predsedavajući: Imamo još dva zahteva koja nam je uputila Organizacija za zaštitu životinja ŠAPA. Predsedavajući počinje da čita zahtev Nevladine organizacije ŠAPA.

Skënder: Samo jedna stvar: dete je napadnuto u Doktorskom naselju, a trovanje pasa lutilica je ponovo počelo. Sada ću reći, zbog medija. Obraćam se medijima na srpskom jeziku, opravdavajući potrebu za pomoći za NVO ŠAPA u vezi sa pitanjem pasa lutilica.

Predsedavajući: Možemo li da stavimo ovo na glasanje? Jer mislim da imamo pravo da usmeravamo subvencije Skupštine prema zahtevima građana. Da li su one za građane ili za nevladine organizacije? Imamo pravo da pomažemo građanima iz subvencija Skupštine.

Predsedavajući: Stavljamo na glasanje zahtev koji nam je uputila Organizacija za zaštitu životinja ŠAPA. Ko je Za?

Zahtev Organizacije za zaštitu životinja ŠAPA za pomoć od 1.500 evra izglasan je sa 11 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Predsedavajući: Čita zahtev građana naselja Tri Solitera, koji traže korišćenje javnog prostora za parkiranje.

Predsedavajući: Takođe čita još jedan zahtev u vezi sa imenovanjem Novog mosta, ali se smatra da isti nije u nadležnosti Skupštine opštine.

Zatvaranje sednice :

Predsedavajući se zahvalio svim učesnicima i zatvorio sednicu.

Sastanak je završen u 16:25 časova.

Zapisničar:

Bujar ISUFI



Predsedavajući Skupštine opštine::

Nedžad UGLJANIN

